



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

---

Ref. nr. 05/811 Dt. 05 / 06 /2017

---

**VENDIM PËR REFUZIMIN E ANKESËS**

Nr. ref. i ankesës 05/769 i datës 19.05.2017 në rastin nr.ref. RN00001675 për pozitën Menaxher i Personelit

Parashtruesi/ja e ankesës: Drita Milazimi

Lënda e ankesës: Shkelja e dispozitave materiale të Rregullores 02/2010 mbi Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil

**KOMISIONI PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE DHE ANKESAVE**

I përbërë nga:

Refik Ibrahim, kryetar

Blerta Dushica, anëtare, dhe

Minire Rexhepi, anëtare

Komisioni shqyrtoi ankesën e dorëzuar nga Drita Milazimi, ku parashtruesja konteston vendimin e KPSHC dhe atë:

1. Kërkon që të anulohen procedurat e rekrutimit lidhur me përzgjedhjen e kandidatit/ës në pozitën Menaxher i personelit
2. Kërkon që të konstatohet shkelja e dispozitave materiale të Rregullore nr. 02/2010
3. Kërkon që të rishpallet konkursi për këtë pozitë

**Baza juridike e ankesës:**

Ankesa është dorëzuar duke u bazuar në nenin 8 të Rregullores nr. 05/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave

Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në përbërje të plotë pasi shqyrtoi dokumentacionin që nga fillimi i procedurave të rekrutimit dhe deri në përfundim të procesit të rekrutimit , përmbledhi të gjitha faktet relevante lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës dhe erdhi në përfundim se:

1. Shpallja e rekrutimit është bërë konformë Ligjit mbi shërbyesit Civil të Kosovës Nr.03/L-149
2. Pas përmylljes së afatit për aplikim në afat është themeluar KPSHC (ad hoc) për zhvillimin e proceduarave të rekrutimit
3. KPSHC i është përmbajtur afateve të përcaktuara sipas Rregullores për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil nr. 02/2010
4. KPSHC i është përmbajtur kritereve të shpallura në konkurs
5. KPSHC ka përcaktuar kriteret për përfshirjen në listën e ngushtë .Këto kritere janë miratuar nga KPSHC në takimin e mbajtur më 13.04.2017
6. Përzgjedhja e listës së ngushtë është bërë në afatin e caktuar ligjor në dhe lidhur me këtë janë njoftuar kandidatët e përzgjedhur
7. Testi me shkrim është kryer më 21.04.2017 në afatin e përcaktuar
8. Rezultatet e testit me shkrim janë publikuar dhe vendosur në formularët standard të MAP si dhe janë nënshkruar nga KPSHC
9. Në testin me gojë i cili është mbajtur më 28.04.2017 janë ftuar të gjitha ata kandidatë të cilët kanë kaluar testin me shkrim
10. Rezultatet e testit me shkrim dhe me gojë janë përmbledhur përmbledhur në formularin MAP-SHCK-08/a
11. Përmbledhja e vlerësimeve individuale të kandidatëve është vendosur në formularin MAP-SHCK-09 dhe është nënshkruar nga KPSHC
12. Në formularin MAP-SHCK-10 është bërë renditja përfundimtare
13. KPSHC në formularin MAP-SHCK -11 ka dorëzuar raportin final mbi rekomandimet e komisionit rekrutues
14. Kandidatja i ka plotësuar kriteret e konkursit mirëpo, vlerësimi me shkrim dhe me gojë nga ana e KPSHC ka ndikur në renditjen përfundimtare të pikëve.

Andaj, komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave gjatë shqyrtimit të lëndës nuk ka mundur të gjej shkelje procedurale dhe lidhur me këtë me vota unanime bie këtë:

## VENDIM

REFUZOHET ANKESA E Znj. Drita Milazimi, si e pa bazuar

### Arsyetim

Komisioni për shqyrtimin e kontesteve dhe ankesave pas shqyrtimit të lëndës së ankesës, materialit të ofruar nga zyra e personelit si dhe shqyrtimin e formularëve të dorëzuar nga KPSHC duke filluar nga formulari MAP-SHCK-01 deri në formularin e fundit MAP-SHCK-11 nuk ka mundur të gjej shkelje të procedurave të rekrutimit.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij vendimi të Komisionit, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, brenda afatit prej 30 ditësh.

Vendimi t'i dorëzohet:



- Palës e cila është ankuar
- Zyrës së personelit në UKZ
- Arkivit
- Të publikohet në ueb faqen zyrtare të UKZ

KOMISIONI PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE DHE ANKESAVE

Refik Ibrahim, Kryetar

Blerta Dushica, anëtare

Minire Rexhepi, anëtar





**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

---

Ref. nr. 05/813 Dt. 05/06 /2017

---

**VENDIM PËR REFUZIMIN E ANKESËS**

Nr. ref. i ankesës 05/754 i datës 12.05.2017 në rastin nr.ref. RN00001675 për pozitën:  
Menaxher i Personelit

Parashtruesi i ankesës: Florim Mustafa

Lënda e ankesës: Shkelja e dispozitave të Ligjit mbi Sherbyesit Civil nr. 03/L-149 të  
Rregullores nr. 02/2010 Për Procedura e Rekrutimit në Shërbimin Civil

**KOMISIONI PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE DHE ANKESAVE**

I përbërë nga:

Refik Ibrahim, kryetar

Blerta Dushica, anëtare, dhe

Minire Rexhepi, anëtare

Komisioni shqyrtoi ankesën e dorëzuar nga Florim Mustafa , ku parashtruesi konteston vendimin e KPSHC për përzgjedhjen e kandidatës Kosovare Shabani, në këto pika :

1. Mos respektimin e katalogut të përshkrimit të detyrave dhe vendeve të punës të publikuar nga MAP-i ;
2. Shkelje të dispozitave të Rregullores nr. 02/2010 Për Procedura e Rekrutimit në Shërbimin Civil ;
3. Parregullsi me rastin e intervistimit të kandidatëve

**Baza juridike e ankesës:**

Ankesa është dorëzuar duke u bazuar në nenin 8 të Rregullores nr. 05/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave

Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në përbërje të plotë pasi shqyrtoi dokumentacionin që nga fillimi i procedurave të rekrutimit dhe deri në përfundim të procesit të rekrutimit , përmbledhi të gjitha faktet relevante lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës dhe erdhi në përfundim se:

1. Komisioni ka gjetur se konkursi në fjalë është bërë sipas Katalogut të MAP-it sepse i njëjti është shpallur përmes sistemit elektronik të MAP – SIMBNJ , i cili automatikisht me rastin e kërkesës për shpalljen e konkursit gjeneron kushtet për atë vend pune dhe nuk lejohen ndërhyrje në sistem
2. Komisioni nuk ka mundur të gjej shkelje eventuale të nenit 7 paragrafi 4 dhe 5 Rregullores Nr. 02/2010 sepse në asnjërin nga paragrafet nuk shkruan se Sekretari i Përgjithshëm nuk ka të drejtë të jetë anëtar i KPSHC
3. Komisioni gjatë shqyrtimit të pretendimit mbi shkeljet eventuale gjatë intervistimit të kandidatëve nuk ka vërejtur shkelje procedurale dhe se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë dyshime të pa bazuara.

Andaj, komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave gjatë shqyrtimit të lëndës nuk ka mundur të gjej shkelje procedurale dhe lidhur me këtë me vota unanime bie këtë:

### **VENDIM**

REFUZOHET ANKESA E Z. Florim Mustafa, si e pa bazuar

### Arsyetim

Komisioni për shqyrtimin e kontesteve dhe ankesave pas shqyrtimit të lëndës së ankesës, materialit të ofruar nga zyra e personelit si dhe shqyrtimin e formularëve të dorëzuar nga KPSHC duke filluar nga formulari MAP-SHCK-01 deri në formularin e fundit MAP-SHCK-11 nuk ka mundur të gjej shkelje të procedurave të rekrutimit.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij vendimi të Komisionit, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, brenda afatit prej 30 ditësh.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Palës e cila është ankuar
- Zyrës së personelit në UKZ
- Arkivit
- Të publikohet në ueb faqen zyrtare të UKZ

KOMISIONI PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE DHE ANKESAVE

Refik Ibrahim, Kryetar

Blertha Dushica, anëtare

Minire Rexhepi, anëtar



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

---

Ref. nr. 05/812 Dt. 05 / 06 /2017

---

**VENDIM PËR REFUZIMIN E ANKESËS**

Nr. ref. i ankesës 05/774 i datës 24.05.2017 në rastin nr.ref. RN00001675 për pozitën:  
Menaxher i Personelit

Parashtruesi i ankesës: Bardhyl Sylja

Lënda e ankesës: Shkelja e dispozitave të Ligjit mbi Sherbyesit Civil nr. 03/L-149 dhe të Rregullores për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave nr. 05/2011

**KOMISIONI PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE DHE ANKESAVE**

I përbërë nga:

Refik Ibrahim, kryetar

Blerta Dushica, anëtare, dhe

Minire Rexhepi, anëtare

Komisioni shqyrtoi ankesën e dorëzuar nga Bardhyl Sylja, ku parashtruesi konteston vendimin e KPSHC për përzgjedhjen e kandidates Kosovare Shabani, në këto pika :

1. Kandidatja e pranuar nuk posedon njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e burimeve njerëzore
2. Kërkon që të konstatohet shkelja e parimit të meritës , aftësisë profesionale, panashmërisë dhe transparencës
3. Kërkon që të rishpallet konkursi për këtë pozitë

**Baza juridike e ankesës:**

Ankesa është dorëzuar duke u bazuar në nenin 8 të Rregullores nr. 05/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave

Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në përbërje të plotë pasi shqyrtoi dokumentacionin që nga fillimi i procedurave të rekrutimit dhe deri në përfundim të procesit të rekrutimit , përmbledhi të gjitha faktet relevante lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës dhe erdhi në përfundim se:

1. Shpallja e rekrutimit është bërë konformë Ligjit mbi shërbyesit Civil të Kosovës Nr.03/L-149
2. Pas përmbylljes së afatit për aplikim në afat është themeluar KPSHC (ad hoc) për zhvillimin e proceduarave të rekrutimit
3. KPSHC i është përmbajtur afateve të përcaktuara sipas Rregullores për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil nr. 02/2010
4. KPSHC i është përmbajtur kritereve të shpallura në konkurs
5. KPSHC ka përcaktuar kriteret për përfshirjen në listën e ngushtë .Këto kritere janë miratuar nga KPSHC në takimin e mbajtur më 13.04.2017
6. Përzgjedhja e listës së ngushtë është bërë në afatin e caktuar ligjor në dhe lidhur me këtë janë njoftuar kandidatët e përzgjedhur
7. Është e vërtetë se kandidati Bardhyl Sylja, ka përvojë substanciale në burime njerëzore, mirëpo kjo është vetëm një nga shkathtësitë e kërkuara sipas konkursit. KPSHC ka bërë vlerësimin e të gjitha kushteve të parapara në konkurs dhe kandidatin Bardhyl Sylja e ka futur në listën e ngushtë për rekrutim
8. Komisioni nuk ka gjetur shkelje të parimit të meritës dhe transparencës nga ana e KPSHC.



Andaj, komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave gjatë shqyrtimit të lëndës nuk ka mundur të gjej shkelje procedurale dhe lidhur me këtë me vota unanime bie këtë:

## VENDIM

REFUZOHET ANKESA E Z. Bardhyl Syla, si e pa bazuar

### Arsyetim

Komisioni për shqyrtimin e kontesteve dhe ankesave pas shqyrtimit të lëndës së ankesës, materialit të ofruar nga zyra e personelit si dhe shqyrtimin e formularëve të dorëzuar nga KPSHC duke filluar nga formulari MAP-SHCK-01 deri në formularin e fundit MAP-SHCK-11 nuk ka mundur të gjej shkelje të procedurave të rekrutimit.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij vendimi të Komisionit, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, brenda afatit prej 30 ditësh.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Palës e cila është ankuar
- Zyrës së personelit në UKZ
- Arkivit
- Të publikohet në ueb faqen zyrtare të UKZ

KOMISIONI PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE DHE ANKESAVE

Refik Ibrahim, Kryetar

Blerta Dushica, anëtare

Minire Rexhepi, anëtar